

**UDC 347.97/.99 (4-672EU)**

**348.64 (4-672EU)**

Prof. Ass. Dr. Bashkim Zahiti<sup>1</sup>

**SISTEMI GJYQËSOR I BASHKIMIT EVROPIAN  
СУДСКИОТ СИСТЕМ ВО ЕВРОПСКАТА УНИЈА  
THE JUDICIAL SYSTEM OF THE EUROPEAN UNION**

*Abstract*

*Legal nature of the European Union with the entry into force of the Lisbon Treaty has undergone a substantial change not only in terms of gaining eligibility acting to solidifying international relations (so, gaining the international subjectivity) but also in terms of defining the responsibilities of basic organs of the European Union. European Union as a legal entity separate type "sui generis" carries through its bodies of three powers, including the judiciary. Judicial power has undoubtedly an important role in the mutual control of European Union bodies and member states through the exercise of various legal tools.*

*Keywords: European Union, the judicial system, the courts, remedies*

*Abstrakt*

Natyra juridike e Bashkimit Evropian me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Lisbonës ka pësuar një ndryshim substancial jo vetëm sa i përket fitimit të zotësisë juridike të vepruarit për të sendërtuar marrëdhëniet ndërkombëtare (pra fitimit të subjektivitetit ndërkombëtar) por edhe sa i përket definimit të kompetencave të Organeve themelore të Bashkimit Evropian. Bashkimi Evropian si një subjekt juridik i llojit të veçantë "sui generis" ushtron nëpërmjet organeve të veta të tri pushtetet, pra edhe pushtetin gjyqësor. Pushteti gjyqësor ka padyshim një rol të rëndësishëm në kontrollin e ndërsjellët të Organeve të Bashkimit Evropian dhe të shteteve anëtare nëpërmjet të ushtrimit të mjeteve të ndryshme juridike.

*Fjalët kyçe: Bashkimi Evropian, sistemi gjyqësor, gjykatat, mjetet juridike*

---

<sup>1</sup> Autori është profesor dhe anëtar i Këshillit Drejtues të Universitetit Publik të Prizrenit "Ukshin Hoti".

## **I. Hyrje**

Ushtrimi i pushtetit gjyqësor në Bashkimin Evropian, si një subjekt juridik i llojit të veçantë, i shërben kontrollit të ndërsjellët si parakusht për një rend demokratik e liberal. Për të ushtruar një pushtet gjyqësor nuk është e nevojshme në radhë të parë që në aspektin normativ të përcaktohet themelimi, organizimi, funksionimi dhe juridiksioni i gjykatave përkatëse.

## **II. Gjykatat e Bashkimit Evropian**

Që nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Lisbonës i gjithë sistemi gjyqësor i Bashkimit Evropian njihet si „Gjykata e Lartë e Bashkimit Evropian”. Gjykata e Lartë e Bashkimit Evropian ushtron pushtetin unik gjyqësor brenda Bashkimi Evropian dhe e garanton drejtësinë gjatë interpretimit dhe implementimin e të traktateve/kontratave themeluese. Në bazë të dispozitës të nenit 19 të *“Traktatit të Bashkimit Evropian”* (në vijim *“TBE”*) sistemi gjyqësor i Bashkimit Evropian (gjegjësisht Gjykata e Lartë Evropiane apo e Bashkimit Evropian) përbëhet nga këto gjykata të pavarura:

- *Gjykata e Lartë (Evropiane)*
- *Gjykata (e Bashkimit Evropian) dhe*
- *Gjykatat e fushëlëmive*

### **1. Gjykata e Lartë (Evropiane)**

#### **a) Përbërja dhe organizimi**

Në bazë të dispozitës të nenit 19 paragrafi 2 të *“TBE”* Gjykata e Lartë (Evropiane) përbëhet nga një gjyqtar për çdo shtet anëtar (çka do të thotë nga 28 gjyqtar gjithsej, shiko nenin 48 të Statutit të Gjykatës së Lartë). Gjykata e lartë gjatë kryerjes së detyrave të veta ndihmohet nga avokatë të përgjithshëm. Në bazë të dispozitës të nenit 252 të *“Traktatit mbi Mënyrën e Punës të Bashkimit Evropian”* (në vijim *“TMPBE”*) numri i avokatëve të përgjithshëm është 8, mirëpo ky numër mundet të rritet sipas kërkesës së gjykatës. Në bazë të dispozitës të nenit 19 paragrafi 2 pika1 të *“TBE”* në lidhje me dispozitat e neneve 253 dhe 254 të *“TMPBE”* sa i përket emërimit të gjyqtarëve dhe të avokatëve duhet të zgjidhen ato personalitete, të cilat ofrojnë të gjitha garancitë e pavarësisë dhe që i plotësojnë të gjitha kushtet për ushtrimin e funksioneve më të larta gjyqësore në vendet e tyre. Mandati i gjyqtarëve dhe i avokatëve të përgjithshëm vazhdon 6 vjet. Megjithatë në bazë të dispozitës të nenit 9 të Statutit të Gjykatës së Lartë (Evropiane) çdo tre vjet bëhet zgjedhja e pjesshme e gjyqtarëve (që ka të bëjë me 13 ose 14 gjyqtarë) dhe të avokatëve të përgjithshëm (që ka të bëjë çdo herë me avokat). Zgjedhja e parë e pjesshme është përcaktuar nëpërmjet shortit. Një rizgjedhje e gjyqtarëve dhe avokatëve të përgjithshëm është e lejueshme.

Në bazë të nenit 253 të “TMPBE” gjyqtarët zgjedhin nga mesi i tyre Presidentin e Gjykatës së Lartë (Evropiane) për një mandat 3 vjeçar nga i cili ka për detyrë të drejtojë punimet dhe mbledhjet e gjykatës. Një rizgjedhje e presidentit është e lejueshme. Sa i përket funksionit të avokatëve të përgjithshëm është për t'u theksuar se ka prejardhje nga sistemi juridik francez dhe është për shumicën e sistemeve juridike të shteteve anëtare i panjohur! Detyra e avokatëve të përgjithshëm është shumë e ngjashme me atë të gjykatësve. Ata janë të obliguar që lidhur me lëndët përkatëse në mënyrë plotësisht të pavarur të japin rekomandimet e veta. Në rekomandimet e veta avokatët e përgjithshëm i gjykojnë çështjet përkatëse nga pikëpamja e tyre dhe nëpërmjet tyre ata ia parashtrojnë kërkesën Gjykatës së Lartë (Evropiane) që të marrë një vendim të caktuar. Gjykata e Lartë (Evropiane) nuk është e detyruar që ti zbatojë rekomandimet sa i përket marrjes së një vendimi, të cilin e kanë kërkuar avokatët e përgjithshëm nëpërmjet të rekomandimit, mirëpo megjithatë në praktikë sipas një statistike të bërë në vitin 1983 Gjykata e Lartë (Evropiane) vetëm në 11,2 % të rasteve ka marrë vendim tjetër nga ai që kanë kërkuar avokatët e përgjithshëm nëpërmjet të rekomandimeve<sup>2</sup>. Në bazë të nenit 14 të Statutit të Gjykatës së Lartë (Evropiane) gjyqtarët dhe avokatët e përgjithshëm janë të obliguar që të banojnë në vendin e selisë të gjykatës. Gjykata e Lartë (Evropiane) e ka selinë në Luksemburg, çka do të thotë se të gjithë gjyqtarët dhe avokatët e përgjithshëm duhet banojnë në Luksemburg. Gjykata e Lartë (Evropiane) në çështjet administrative dhe procedurale përkrahet nga një **Kancelar** të cilin gjykata në bazë të nenit 253 paragrafi 5 të “TMPBE” dhe të nenit 12 të Rregullores së Procedurës e zgjedhë për një mandat 6 vjetarë. Kancelari gjatë ushtrimit të detyrave dhe kompetencave të veta ju nënshtrohet direktiva të gjykatës. Seancat e Gjykatës së Lartë (Evropiane) janë publike me përjashtim të atyre në të cilat merret vendimi. Vendimet, që firmosen nga presidenti dhe kancelari, duhet të jenë të arsyetuara dhe të lexohen në seancë publike. Vendimet e Gjykatës së Lartë (Evropiane) janë të formës së prerë dhe përbëjnë objekt rishikimi vetëm në raste krejt të veçanta. Më pastaj ato kanë karakter detyrimues për palët në gjykim dhe kanë forcë ekzekutive brenda shteteve anëtare.

#### **b) Detyrat dhe kompetencat**

Në bazë të dispozitës të nenit 19 paragrafi 1 pika 2 të “TBE” Gjykata e Lartë (Evropiane) siguron respektimin e së drejtës në interpretimin dhe zbatimin e kontratave themeluese. Ky formulim është sa duhet i përpiktë, sepse Gjykata e Lartë sa i përket veprimeve juridike të organeve të Bashkimit Evropian gjegjësisht të shteteve anëtare nuk është e kufizuar që veprimet e tyre ti kontrollojë vetëm sa i përket respektimit të normave të përcaktuara në

---

<sup>2</sup> Bashkim Zahiti: E Drejta Evropiane, botimi i tretë, Prishtinë 2013.

kontratat themeluese por edhe sa i përket burimeve primare dhe sekondare të së drejtës evropiane, si edhe të parimeve të përgjithshme të drejtësisë<sup>3</sup>. Pra me një fjalë detyrat dhe kompetencat e Gjykatës së Lartë (Evropiane) janë që të kontrollojë dhe sigurojë respektimin e së drejtës në interpretimin dhe zbatimin e normave të përcaktuara në kontratat (traktatet) themeluese nga ana e institucioneve legjislative dhe ekzekutive të Bashkimit Evropian si dhe të shteteve anëtare. Në këtë aspekt Gjykata e Lartë (Evropiane) ushtron detyrën e një lloj gjykate kushtetuese të Bashkimit Evropian (por edhe jo vetëm të tij) juridiksioni i të cilës përfshinë: veprimin e shteteve anëtare, veprimin ose mosveprimin e organeve të Bashkimit Evropian, si dhe një varg çështjesh tjera gjyqësore. Sa i përket juridiksionit gjyqësor të Gjykatës së Lartë (Evropiane) është për tu theksuar se ajo pushtetin gjyqësor e ushtron nëpërmjet të disa llojeve të procedurave, të cilat sa i përket të drejtës për inicim të procedurës, palëve në konflikt dhe efektit të vendimit të gjykatës kanë karakter të ndryshëm. Këtu bëjnë pjesë para së gjithash: *paditë lidhur me shkeljen e kontratës themeluese, paditë lidhur me anulimin e akteve ligjore, paditë lidhur me mosveprimin e organeve të Bashkimit Evropian, paditë lidhur me shkeljen e kontratave themeluese, juridiksioni jo gjyqësor etj.*

### **c) Mënyra e marrjes të vendimeve**

Vendimet e Gjykatës së Lartë të Drejtësisë merren në përgjithësi me shumicën e votave. Për të qenë Gjykata e aftë për të marrë vendime është e nevojshme që të jenë të pranishëm në seancë të paktën 9 gjykatës. Prania e të gjithë gjykatëseve është e nevojshme vetëm atëherë kur njëra nga palët në konflikt e kërkon një gjë të tillë. Sa i përket mendimeve të senateve numri i anëtare që duhet të jetë prezent për formimin e kuorumit është i varur nga madhësia, pra nga vetë numri i anëtarëve të senatit (trupit gjykues). Në bazë të nenit 26, paragrafi i parë, të Rregullores të procedurës të Gjykatës së Lartë të Drejtësisë, Gjykata e Lartë e Drejtësisë mundet të marr një vendim vetëm atëherë kur numri i gjykatësve të pranishëm është numër tek. Sipas kësaj dispozite kur numri i gjykatësve që janë prezent në seancë është numër qift, atëherë gjykatësi më i ri për nga mandati nuk merr pjesë në seancën e Gjykatës. Kjo do të thotë se numrat, 14, 12, dhe 10 sa i përket Gjyqtarëve prezent në seancë nuk mundet të vjen në shprehje, kurse tetëshi nuk mjafton kështu e ashtu sa i përket kuorumit!

### **ç) Statuti dhe rregullorja e punës**

Gjykata e Lartë e Drejtësisë sa i përket dispozitave të veçanta lidhur me zhvillimin e procedurave përkatëse shërbehet nëpërmjet të rregullores dhe statutit të vet. Rregullorja e procedurës të Gjykatës së Lartë të Drejtësisë ka karakter të ngjashëm me ato të gjykatave

---

<sup>3</sup> Hemmer/Wüß/Hutcka, Europarecht, f. 54.

nacionale të shteteve anëtare. Pra aty janë të rregulluar në mënyrë të detajuar çështjet procedurale. Ndërsa statuti rregullon në radhë të parë organizimin e brendshëm të gjykatës.

## **2. Gjykata (e Bashkimit Evropian)**

Fillimet e Gjykatës (të Bashkimit Evropian) i gjejmë në Vitin 1989 kur ishte themeluar me qëllim që të shkarkoj ngarkesën e punës të Gjykatës së Lartë (Evropiane). Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Lisbonës ish-gjykata e shkallës së parë është emëruar në bazë të nenit 17 të “TBE” vetëm si “Gjykatë”! Ndërsa joformalisht njihet edhe si “Gjykata e Bashkimit Evropian”. Dallimi mes Gjykatës (të Bashkimit Evropian) dhe Gjykatës së Lartë (Evropiane) qëndron në radhë të parë në atë se Gjykata (e Bashkimit Evropian) nuk është organ i Bashkimit Evropian<sup>4</sup>. Po ashtu Gjykata (e Bashkimit Evropian) është vetëm gjykatë e instancës së parë. Vendimet e Gjykatës (të Bashkimit Evropian) mundën nën kushte të caktuara të apelohej pranë Gjykatës së Lartë (Evropiane). Në bazë të dispozitës të nenit 19 paragrafi 2 të “TBE” Gjykata (e Bashkimit Evropian) sikurse Gjykata e Lartë (Evropiane) përbëhet nga një gjyqtarë për çdo shtet anëtar të Bashkimit Evropian, çka do të thotë gjithsej 28 anëtar. Për dallim nga Gjykata e Lartë (Evropiane) Gjykata (e Bashkimit Evropian) nuk është e obliguar të emëroj edhe avokatët e përgjithshëm, neni 49 i Statutit të Gjykatës (të Bashkimit Evropian). Anëtarë të Gjykatës (të Bashkimit Evropian) duhet të zgjidhen vetëm ata persona të cilët i plotësojnë të gjitha kushtet e pavarësisë dhe disponojnë të gjitha kualifikimet për të ushtruar profesionin e gjyqtarit. Ata emërohen nga qeveritë e shteteve anëtare nëpërmjet të mirëkuptimit të ndërsjellët për një mandat 6 vjeçar; çdo 3 vite bëhet një emërim i pjesshëm i gjykatësve. Një riemërim i anëtarëve të Gjykatës (të Bashkimit Evropian) është i lejueshëm.

Në bazë të dispozitës të nenit 254 paragrafi 4 të “TMPBE” Gjykata (e Bashkimit Evropian) në marrëveshje me Gjykatën e Lartë (Evropiane) e nxjerr rregulloren e vet të procedurës, mirëpo kjo duhet të miratohet nga Këshilli (i Bashkimit Evropian).

## **3. Gjykatat e fushëlëmive**

Mundësia e themelimit të gjykatave të fushëlëmive të ndryshme është paraparë qysh me Kontratën e Nicës dhe është e kodifikuar në dispozitën e nenit 257 të “TMPBE”. Sipas kësaj Parlamenti Evropian dhe Këshilli (i Bashkimit Evropian) në procedurën e rregullt legislative mundën të themelojnë gjykata të fushëlëmive të ndryshme të cilat janë kompetente në instancë të parë për paditë e veçanta nga këto fushëlëmi. Po ashtu Parlamenti Evropian dhe

---

<sup>4</sup> Hemmer/Wüst/Hutka, Europarecht, f.55.

Këshilli (i Bashkimit Evropian) me propozim të Komisioni apo me kërkesë të Gjykatës së Lartë (Evropiane) mundën t'i miratojnë Rregulloret e Procedurës së Gjykatave të Fushëlëmive. Në rregullore të procedurës përcaktohet përbërja dhe kompetencat e gjykatave të fushëlëmive, ku pos tjerash në bazë të paragrafi 3 të "TMPBE" duhet të lejohet nën kushte të veçanta ushtrimi i mjeteve juridike kundër vendimeve në instancë të parë. Kjo do të thotë se edhe për paditë kundër vendimeve në instancë të parë të gjykatave të fushëlëmive është kompetente në instancë të fundit (dyshkallësia e sistemit gjyqësor të Bashkimit Evropian) Gjykata e Lartë (Evropiane). Mundësia për themelin e gjykatave të fushëlëmive sipas dispozitës së nenit 257 të "TMPBE" deri tani është shfrytëzuar vetëm një herë kurë me një vendim të Këshillit (të Bashkimit Evropian) të datës 2 Nëntor 2004 është themeluar "*Gjykata për Shërbimet Publike*". Gjykata për Shërbimet Publike ka filluar punën me 12 Dhjetorë 2005. Ajo përbëhet nga 7 anëtar të cilët i emëron Këshilli (i Bashkimit Evropian) unanimisht<sup>5</sup>. Në bazë të nenit 1 të Anexit I të vendimit të Këshillit (të Bashkimit Evropian) mbi themelimin e Gjykatës për Shërbimet Publike kjo gjykatë është kompetente në shkallë të parë për të gjitha paditë e zyrtarëve/shërbyesve të institucioneve të Bashkimit Evropian kundër Organeve të Bashkimit Evropian dhe anasjelltas.

### **III. Mjetet juridike**

Sistemi gjyqësor i Bashkimit evropian parasheh një diversitet të mjeteve juridike si për shembull: Padia mbi shkeljen e traktateve/kontratave themeluese, Padia mbi anulimin e akteve juridike, Padia mbi dëmshpërblimin etj.

#### **1. Padia lidhur me shkeljen e traktateve themeluese**

Kompetencat e Gjykatës së Lartë (Evropiane) janë mjaft të ndryshme dhe heterogjene lidhur me qëllimin e garantimit dhe respektimit të së drejtës gjatë interpretimit dhe aplikimit të traktateve themeluese. Në dispozitat e neneve 258 dhe 259 të "TMPBE" i është dhënë Gjykatës së Lartë (Evropiane) kompetenca që të gjykojë lidhur me mosmarrëveshjet që janë krijuar si rezultat i bindjes së fituar, se njëri nga shtetet anëtare nuk ka vepruar konform normave të përcaktuara në traktatet (kontratat) themeluese. Në praktikë procedura që ka për qëllimi nxjerrjen e një vendimi të Gjykatës së Lartë (Evropiane) i cili konstaton mospërmbushjen e detyrimit nga një shtet anëtar, vihet në lëvizje (iniciohet) pothuajse rregullisht nga Komisioni (Evropian). Kur Komisioni (Evropian) konstaton se një shtet anëtar nuk ka plotësuar një prej detyrimeve që i dalin atij në sajë të kontratave themeluese, ai nxjerr

---

<sup>5</sup> Opperman/Classen/Nettesheim: Europarecht, f.67, München 2011.

një mendim të arsyetuar (pra këtu duhet pasur parasysh se Komisioni është i obliguar që ti arsyetojë dyshimet e veta në mënyrë konkrete dhe të përcaktojë se me cilin veprim konkret shteti anëtar ka shkelur një normë të së drejtës evropiane) në lidhje me këtë, mbasi që ai t'i këtë krijuar kushtet shtetit përkatës që të shprehë kundërshtimet e tij lidhur me këtë konstatim të Komisionit (Evropian). Zakonisht në praktikë Komisioni (Evropian) i jep një afat kohor prej dy muajve shtetit anëtar që të prononcohet lidhur me çështjen përkatëse. Këtë afat kohor prej dy muajsh e ka pranuar si të mjaftueshëm në përgjithësi edhe Gjykata e Lartë (Evropiane) në juridikaturën e vet<sup>6</sup>. Në raste të caktuara duhet pasur kujdes që afati kohor, që i jepet shtetit anëtar që të prononcohet, të mos jetë tepër i shkurtër. Sa i përket objektivit të procedurës këtu mund të vjen në shprehje si shkelja e normave të burimeve primare një ashtu edhe shkelja e normave të burimeve sekondare të së drejtës evropiane. Ndërsa sa i përket subjektivit që ka shkelur normat e përcaktuara në kontratën themeluese është e parëndësishme se cili *organ shtetëror* e ka bërë këtë shkelje të normave. Pra nuk ka rëndësi edhe atëherë kur këtë shkelje të normave e ka bërë një organ i pavarur siç është parlamenti apo siç janë gjykatat<sup>7</sup>. Shtetet anëtare janë në tërësi përgjegjëse (sipas parimit të përgjegjësisë së plotë të shteteve anëtare) për të gjitha institucionet nacionale që ushtrojnë pushtet. Me nxjerrjen e mendimit të arsyetuar nga ana Komisionit hapet një fazë e parë kundërshtimi e mospërbushjes së detyrimit para vetë Komisionit (Evropian), e cila nuk ka karakter gjyqësor dhe synon vetëm të përcaktojë në mënyrë të saktë pozitën e subjekteve që do të bëhen palë më pastaj në një gjykim të mundshëm. Në përfundim të kësaj faze konsultimesh Komisioni (Evropian) shpreh në fakt pozicionin e tij në një mendim, i cili duke mos qenë me karakter detyrues nuk mund të ketë kuptim tjetër veç atij që të saktësojë qëndrimin e Komisionit (Evropian). Shteti të cilit i është drejtuar ky mendim mund t'i përshtatet, duke mbajtur në këtë mënyrë një këndvështrim të njëjtë me atë të Komisionit (Evropian), ose të mos e përfilli fare atë duke theksuar që pozicioni i tij në lidhje me ekzistencën e mospërbushjes së detyrimit është i ndryshëm nga ai që ka shprehur nga Komisioni (Evropian).

Asnjë akt i kësaj faze nuk i detyron në mënyrë përfundimtare palët, e veçanërisht nuk e detyron Komisionin (Evropian). Sipas juridikaturës të Gjykatës së Lartë (Evropiane) pjesa e procedurës që i paraprin paraqitjes së çështjes në gjykatë përfaqëson një fazë paragjyqësore që është e predestinuar ta shtyjë shtetin anëtar t'i përshtatet kontratave themeluese. Kjo fazë nga ana e Komisionit nuk sjell asnjë akt me karakter juridik të detyrueshëm. Vetëm pas kalimit të fazës paragjykimore lind një mosmarrëveshje e vërtetë mbi ekzistencën ose jo të një shkeljeje

---

<sup>6</sup>Hemmer/Wüß/Hutcka, Europarecht, f. 198.

<sup>7</sup>Gjykata e Lartë (Evropiane), Slg. 170, 237, 243; 1970, 961, 966; 1980, 353

të detyrimeve që dalin nga kontratat themeluese e cila mundet të zgjidhet vetëm nga një organ gjyqësor kompetent si Gjykata e Lartë (Evropiane). Lidhur me këtë në dispozitën e nenit 258 paragrafi 2 të “TMPBE” është përcaktuar shprehimisht, se nëse shteti në konflikt nuk pajtohet brenda një afati të caktuar me mendimin e Komisionit (Evropian), atëherë Komisioni mundet t`i drejtohet Gjykatës së Lartë (Evropiane). Procedura para gjykatës ka për objekt faktet e kundërshtuara në letrën mbi vonesën e shtetit anëtar që i dërgohet atij nga Komisioni (evropian) dhe më pas në mendimin e arsyetuar. Është për t`u theksuar se objekti i procedurës nuk mundet të zgjerohet gjatë zhvillimit të gjykimit. Siç e cekëm edhe më lartë, përveç të Komisionit (Evropian), procedurën për konstatimit e shkeljes së kontratave themeluese mund ta iniciojë gjithsecili shtet anëtar i Bashkimit Evropian. Këtu duhet theksuar po ashtu se procedura për konstatimin e shkeljes së kontratave themeluese është e vetmja që u lejohet shteteve anëtare për t`u dhënë fund mosmarrëveshjeve midis tyre në lidhje me mosrespektimin e detyrimeve të kaluara nga kontratat themeluese. Kjo mundësi për padi u është njohur shprehimisht shteteve anëtare në dispozitën e nenit 259 të „TMPBE” para së gjithash për të evituar një mospërputhje pikëpamjesh midis Komisionit (Evropian) dhe shteteve anëtare lidhur me implementimin e kontratave themeluese, dhe që në këtë mënyrë t`u epet mundësia shteteve anëtare që t`i mbrojnë opinionet e tyre me mjete juridike. Prandaj neni 259 i “TMPBE” u jep shteteve anëtare një të drejtë padie të njëjtë ma atë të Komisionit, duke përcaktuar që secili prej shteteve anëtare mund ti drejtohet Gjykatës së Lartë (Evropiane) kur ai mendon se një shtet tjetër anëtar nuk ka përmbushur ndonjë prej detyrimeve lidhur me respektimin e kontratave themeluese. Ushtrimi i të drejtës së padisë nga ana e shteteve anëtare është i kushtëzuar nga një fazë jogjyqësore e destinuar që të bëj përcaktimin e këndvështrimeve të palëve me qëllim që një vajtje në gjykatë të bëhen vetëm në rastin e ekzistencës së një mosmarrëveshje efektive midis tyre. Lidhur me këtë paragrafi 2 i nenit 259 të “TMPBE” përcakton që një shtet anëtar duhet ti drejtohet Komisionit (Evropian) para se të bëj një padi kundër një shteti tjetër anëtar të bazuar mbi pretendimin e një shkeljeje të detyrimeve që këtij të fundit i takojnë në kuadër të kontratave themeluese. Pra para ngritjes të padisë nga një shtet anëtar Komisioni (Evropian) duhet ballafaqohet me çështjen përkatëse në bazë të kërkesës të parashtruar shprehimisht nga shteti anëtar i cili parashikon të ngrit padinë. Në këto raste Komisioni, ngjashëm me procedurën e nenit 258 të “TMPBE”, hapë një fazë konsultimesh me shtetet e interesuara në të cilën ballafaqohen pikëpamjet dhe kontradiktat lidhur me çështjen në fjalë. Në përfundim të kësaj faze paragjykimore shteti i interesuar mundet të i drejtohet Gjykatës së Lartë (Evropiane) vetëm pasi të ketë shprehur një mendim të vetin Komisioni (Evropian) lidhur me çështjen në fjalë. Komisioni (Evropian) në bazë të



dispozitës të nenit 259 paragrafi 4 të „TMPBE” ka një afat kohorë prej 3 muajve që të shpreh mendimin e vet lidhur me çështjen në fjalë. Mbas kalimit të këtij afati shteti i interesuar mundet t’i drejtohet Gjykatës së Lartë (Evropiane) pavarësisht se a shpreh apo nuk e shpreh mendimin e vetë Komisioni (Evropian). Prononcimi i Komisionit (Evropian) edhe në rast mosmarrëveshje midis shteteve anëtare synon natyrisht një objektiv të dyfishtë:

- *Nga njëra anë ai synon të evitohet për atë sa është e mundur një gjyq të ardhshëm. Në fakt është e mundur që qëndrimi i Komisionit (Evropian), i favorshëm ndaj pozicionit të njërit prej shteteve të interesuara, e çon tjetrin shtet anëtar ose në ndryshimin e qëndrimit të tij (kur bëhet fjalë për shtetin që mendohet të jetë mospërbushjes i detyrimit), ose të heqë dorë nga padia (kur bëhet fjalë për shtetin që e ka nxitur procedurën).*
- *Më tutje mendimi i Komisionit (si një organ i Bashkimit Evropian) ka për qëllim të e përfshijë Bashkimin Evropian në çfarëdo lloj mosmarrëveshjeje midis shteteve anëtare në lidhje me respektimin e kontratave themeluese dhe të sigurojë që në një gjykim të mundshëm të merren parasysh jo vetëm pikëpamjet e rivalëve, por edhe e në radhë të parë interesi i përgjithshëm i Bashkimit Evropian.*

Në përgjithësi duhet theksuar se paditë e shteteve anëtar sipas nenit 259 të „TMPBE” lidhur me shkeljen e kontratave themeluese nga një tjetër shtet anëtar në praktikë janë të rralla për shkak vetë rolit të Komisionit (Evropian) si “*Roja e traktateve themeluese*”, i cili përkujdeset vetë *ex-officio* që t’i denoncojë shkeljet eventuale siç është e paraparë në nenin 258 të “TMPBE”. Në bazë të dispozitës të nenit 260 paragrafi 1 të “TMPBE” nëse akuzat e shprehura nëpërmjet të padisë janë të bazuara atëherë Gjykata e Lartë (Evropiane) konstaton se shteti anëtar ka shkelura detyrimet e veta që atij i ngarkohen nga kontratat themeluese. Në këtë rast shteti anëtar është i detyruar që t’i ndërmarr të gjitha masat e nevojshme që janë të përcaktuara në vendimin e Gjykatës së Lartë (Evropiane). Nëse shteti anëtar nuk i ndërmerr këto masa brenda afatit të caktuar, atëherë Komisioni në bazë të dispozitës të nenit 260 paragrafi 2 të “TMPBE” pasi ti ketë dhënë mundësinë për prononcim shtetit anëtar, nxjerr një mendim të arsyetuar në të cilin ai përcakton se cilat pika të vendimit të Gjykatës së Lartë shteti anëtar nuk i ka plotësuar. Nëse shteti përkatës nuk i ndërmerr masat e përcaktuara nga Gjykata e Lartë brenda afatit që atij ia ka vënë Komisioni (Evropian), atëherë ky i fundit mundet të thërras Gjykatën e Lartë (Evropiane) dhe të shtrojë kërkesën që shteti anëtar të paguaj një gjobë paushallë, të cilën Komisioni (Evropian) e sheh si të arsyeshme.

## **2. Padia lidhur me anulimin e akteve juridike**

Në përgjithësi në bazë të nenit 19 të “TBE” ushtrimi i pushteti gjyqësor nga ana e Gjykatës së Lartë (Evropiane) ka për qëllim mbrojtjen e së drejtës gjatë interpretimit dhe implementimit të kontratave themeluese. Në këtë aspekt bënë pjesë sipas dispozitës së nenit 263 të „TMPBE” kompetenca e Gjykatës së Lartë (Evropiane) që të shqyrtojë ligjshmërinë e akteve normative si dhe të veprimeve të Këshillit (Evropian), të Komisionit (Evropian) dhe Bankës Qendrore Evropiane. Objekt i shqyrtimit mundë të jetë çdo *lëshim* i organe të lartpërmendura, i cili mundë të kryhet me *veprim* ose *mosveprim*, çka do të thotë se një shkelje e kontratave themeluese mund të karakterizohet në fakt në nxjerrjen e akteve kundër ligjore ose në abstenimin nga nxjerrja e akteve të duhura. Të dyja këto mundësi janë të parashikuara nga kontratat themeluese, të cilat ua lejojnë institucioneve, shteteve anëtare dhe nën kushtet e caktuara edhe individëve të veçantë që të ngrenë padi kundër shkeljeve të lart përmendura përpara Gjykatës së Lartë (Evropiane) për të siguruar respektimin e kontratave themeluese nga ana e organeve të Bashkimit Evropian. Prandaj në lidhje me këtë në dispozitën e nenit 263 paragrafi 1 të „TMPBE” është e përcaktuar shprehimisht që Gjykata e Lartë (Evropiane) ushtron një kontroll ligjshmërie mbi aktet e përbashkëta të Parlamentit Evropian dhe Këshillit (të Bashkimit Evropian) si dhe mbi aktet e Këshillit (Evropian) dhe të Bankës Qendrore Evropiane nëse nuk ato nuk janë rekomandime (propozime) ose mendime, si dhe mbi aktet e Parlamentit Evropian të cilat kanë një efekt juridik kundër një subjekti të tretë. Po ashtu Gjykata e Lartë (Evropiane) ka kompetencë të ushtrojë pushtetin e kontrollit të ligjshmërisë edhe kundrejt veprimeve të organeve tjera të Bashkimit Evropian nëse ato prodhojnë efekt juridik kundër subjekteve të treta. Legjitimitetin për pjesëmarrje aktive në procedurë, gjegjësisht për të ngritur padi pranë Gjykatës së Lartë (Evropiane) lidhur me ligjshmërinë e një akti të organeve të lartpërmendura, e ka në radhë të parë sipas dispozitës të nenit 262 paragrafi 2 të “TMPBE” një shtet anëtar, Parlamenti Evropian, Këshilli (i Bashkimit Evropian) dhe Komisioni (Evropian). Po ashtu legjitimitetin për pjesëmarrje aktive në procedurë në bazë të dispozitës të nenit 263 paragrafi 3 të “TMPBE” e kanë edhe Gjykata e Llogarive, Banka Qendrore Evropiane si dhe Komiteti i Regjioneve, nëse këta janë të prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe individualisht nga veprimi, ligjshmërinë e të cilit këta e kontestojnë nëpërmjet të padisë. Edhe personave juridik dhe fizik ju njihet legjitimiteti për të ngritur një padi pranë Gjykatës së Lartë (Evropiane) në bazë të nenit 263 paragrafi 4 të “TMPBE” lidhur me kundërshtimin e akteve juridike nëse ata janë të prekur individualisht nga aktet juridike apo veprimet e organeve të Bashkimit Evropian. Ky legjitimitet është pak a shumë i kufizuar, sepse në radhë të parë kompetente për të gjykuar mbi padinë e privatëve është Gjykata (e Bashkimit Evropian e cila më parë ka qenë e njohur si *Gjykatë e Shkallës së*

*Parë*) në bazë të nenit 3, paragrafi 1 pika c e Vendimit<sup>8</sup> të Këshillit (të Bashkimit Evropian) të datës 24 Tetorë 1988. Në fakt paragrafi 4 i nenit 263 të “TMPBE” të Kontratës mbi themelimin e Bashkësisë Evropiane, parasheh që çdo person juridik ose fizik mund të parashtrijë - nën të njëjtat kushte të paragrafi 1 dhe 2 - një padi kundër vendimeve të marra ndaj tije dhe kundër akteve juridike me karakter rregullativ të cilat nuk sjellin me vete masa të implementimit. Si subjekt i padisë mund të vijë në shprehje të gjitha ato akte apo veprime të organeve të Bashkimit Evropian, të cilat janë në gjendje të krijojnë një efekt juridik gjegjësisht që kanë një efekt juridik<sup>9</sup>. Deri sa kemi të bëjmë me një padi të palëve të përcaktuara në dispozitat e paragrafit 2 dhe 3 të nenit 262 të “TMPBE” atëherë si objekt i padisë vijë në shprehje aktet dhe veprimet e përbashkëta të Këshillit dhe Parlamentit Evropian (sipas procedurës të rregullt legislative të nenit 294 të “TMPBE”), si dhe veprimet e pavarura të Këshillit, Komisionit dhe të Bankës Qendrore Evropiane, deri sa këtu nuk kemi të bëjmë me rekomandime ( propozime ) dhe mendime në kuptimin e dispozitës të nenit 288 të “TMPBE”. Aktet apo veprimet e pavarura të Parlamentit Evropian mund të jenë objekt i padisë mbi anulimin e akteve juridike sipas dispozitës të nenit 263 të “TMPBE” vetëm atëherë kur këto krijojnë gjegjësisht kanë një efekt juridik kundrejt personave të tretë, qofshin këta edhe organet e Bashkimit Evropian. Ndërsa kur kemi të bëjmë me paditë e personave juridik apo fizik si objekte të padisë mbi anulim e akteve juridike vjen në shprehje vetëm vendimet në kuptimin e nenit 288 paragrafi 4 të “TMPBE”. Lidhur me këtë nuk është me rëndësi emërimi apo forma e jashtme e aktit, ligjshmëria e të cilit është vënë në pyetje, por përmbajtja e tij materiale. Neni 263 paragrafi 4 i “TMPBE” përcakton çartë se objekt i padisë mbi anulimin e akteve juridike mund të jenë edhe vendimet të cilat janë shpallur në formë të dekretive. Përveç kësaj që thamë më lartë për ngritjen e padisë mbi anulimin e akteve të organeve të Bashkësisë Evropiane është i nevojshëm edhe legjitimiteti përkatës. Edhe sa i përket legjitimiteti është vendimtare se kush e bën ngritjen e padisë. Deri sa kemi të bëjmë me një padi të ngritur nga shtetet anëtare, nga Këshilli apo Komisioni atëherë dispozita e nenit 263 paragrafi 2 i “TMPBE” nuk kërkon ndonjë legjitimitet të posaçëm. Pra këtu kemi të bëjmë me të ashtuquajturin legjitimitet të privilegjuar. Prapavija e kësaj qëndron në faktin se shtetet anëtare, Këshilli dhe Komisioni së bashku bartin përgjegjësinë e përgjithshme për mbrojtjen e vlerave të drejtës evropiane. Lidhur me këtë shtetet anëtare, Këshilli dhe Komisioni mund ta kundërshtojnë, sulmojnë me mjete juridike të rregullta çdo akt juridik të Bashkimit Evropian pa qenë fare të prekur nga ai apo pa pasur nevojë që në kërkesën për

---

<sup>8</sup> BE (88/591)

<sup>9</sup> Hemmer/Wüst/Hutka, Europarecht, f. 202; Gjykata e Lartë (Evropiane), Rs. 22/70 Slg. 1971, 263, 277; Rs.294/83 Slg. 1986, 1339, 1365; Rs. 34/86 Slg.1986, 2155, 2201

anulimin e tij të pohojnë se lidhur me këtë kanë interesa të veçanta. Kjo vlen edhe në ato raste në të cilat organet në fjalë kanë bashkëvepruar në katin kontestues<sup>10</sup>. Ndërsa sa i përket padive të ngritura nga Gjykata e Llogarive, Banka Qendrore Evropiane dhe Komiteti i Regjioneve dispozita e nenit 263 paragrafi 3 të “TMPBE” ju njeh këtyre legjitimitetin për ngritjen e padisë lidhur me anulimin e akteve juridike vetëm atëherë, kur nëpërmjet të kësaj këta i mbrojnë interesat e veta. Pra siç shihet Gjykata e Llogarive, Banka Qendrore Evropiane dhe Komiteti i Regjioneve nuk janë të privileguara sa i përket legjitimitetit lidhur me ngritjen e padisë mbi anulimin e akteve juridike. Sa i përket legjitimitetit të personave juridik dhe fizik për ngritjen e padive që kanë të bëjnë me anulimin e akteve juridike, ky iu është njohur këtyre vetëm në raste të veçanta të cilat janë përcaktuar shprehimisht në dispozitën e nenin 263 paragrafi 4 i “TMPBE”. Sipas kësaj dispozite paditë nga ana personave juridikë apo fizikë mund të ngritën vetëm kundër atyre vendimeve të cilat janë të adresuara kundër tyre dhe kundër vendimeve, që duken si rregullore apo që janë të marra ndaj personave tjerë, mirëpo i prekin këta drejtpërdrejtë dhe individualisht. Pra siç shprehet edhe vetë norma, legjitimiteti për kundërshtim është i kufizuar, për sa i përket subjekteve private, tek personat të cilëve u drejtohen vendimet e organeve të Bashkimit Evropian si dhe në subjektet që, megjithëse duke mos qenë formalisht të adresuar të aktit të organeve të Bashkimit Evropian (qoftë sepse bëhet fjalë për rregullore qoftë sepse bëhet fjalë për një vendim formalisht të drejtuar tjerëve), merren në konsideratë të drejtpërdrejtë dhe individualisht nga vetë ky akt. Pra paditësi, personi juridik apo fizik, së pari duhet të jetë i prekur në mënyrë të drejtpërdrejt nga akti juridik anulimin e të cilit ai e synon. Në mënyrë të drejtpërdrejtë është i prekur një person juridik apo fizik kur një vendim i organeve të Bashkimit Evropian formalisht i është drejtuar tjerëve, mirëpo efekti i tij atë rrjedhimisht e prekë, pa pasur nevojë që të krijohen rrethana tjera. Pra këtu është e nevojshme që efekti i aktit juridik, të organeve të Bashkimit Evropian, i cili formalisht i është drejtuar tjerëve, të prekë në mënyrë konkrete sferën e së drejtës të një personi juridik apo fizik. Sa i përket vendimeve që ju drejtohen shteteve anëtare, për përcaktimin e efektit të drejtpërdrejtë për personat juridikë dhe fizikë, është vendimtare se a detyrohen apo autorizohen shtetet anëtare për zbatimin e tij nëpërmjet të normave juridike nacionale. Kur kemi të bëjmë me vendime të organeve të Bashkimit Evropian, të cilat i autorizojnë shtetet anëtare, që nëpërmjet të normave nacionale të rregullojnë një çështje të caktuar, atëherë nuk kemi të bëjmë me një prekje të drejtpërdrejtë të drejtave të një personi juridik apo fizik, për shkak se këtu shtetit të autorizuar i mbetet një hapësirë manovruese sa i përket marrjes së masave të nevojshme lidhur me këtë. Kështu që personat juridikë apo fizikë

---

<sup>10</sup> Gjykata e Lartë (Evropiane), Rs. 22/70, Slg. 1971, 263, 278.

preken në të drejtat e veta tek nëpërmjet të aktit juridik të shtetit anëtar<sup>11</sup>. Ndërsa kur kemi të bëjmë me vendime të organeve të Bashkimit Evropian të cilat i detyrojnë shtetet anëtare që nëpërmjet të normave juridike nacionale të rregullojnë një çështje të caktuar, atëherë këto akte juridike i prekin drejtpërdrejtë të drejtat e personave juridikë dhe fizikë edhe pse formalisht nuk u janë drejtuar atyre. Më pastaj kusht tjetër sa i përket legjitimitetit të personave juridik apo fizik lidhur me ngritjen e padive në kuptimin e dispozitës të nenit 262 paragrafi 4 të “TMPBE” është edhe që vendimi i organeve të shteteve anëtare, anulimi i të cilit nëpërmjet të padisë synohet të arrihet, i cili formalisht i është drejtuar tjetërkujt, të prekë edhe individualisht të drejtat e paditësit, pra të personit juridik apo fizik që synon anulimin e tij. Sipas judikaturës të Gjykatës së Lartë (Evropiane) një person i ndryshëm nga ai të cilit ju është drejtuar vendimi është i prekur individualisht, kur një vendim atë, për shkak të vetive dhe cilësive të veta, apo, në rrethin e shumë personave në rrethana të njëjta, posaçërisht e prekë dhe e individualizon mu sikurse adresatin e vet të cilit i është drejtuar vendimi<sup>12</sup>.

Mirëpo këtu duhet dalluar rastet kur një person në vendim për shkak të përkatësisë së tij në një grup të caktuar përcaktohet dhe vetëm sa i përket përkatësisë së tij grupore preket nga masat e marruara në vendim<sup>13</sup>. Pra nuk kemi të bëjmë me një “prekje individuale” kur një person është i prekur nga një vendim, për shkak të përkatësisë të llojit, të “familjes” apo të gjinisë së tij, edhe në qoftë se në momentin e marrjes të vendimit numri apo emrat e personave të prekur kanë qenë të përcaktuar<sup>14</sup>; apo edhe kur faktikisht vetëm një person preket nga masa e marrë nëpërmjet vendimit. Gjykata e Lartë (Evropiane) në judikaturën e vet e ka pranuar një “prekje individuale” para së gjithash në ato raste kur, numri dhe identiteti i personave të prekur në momentin e marrjes të vendimit ka qenë i përcaktuar dhe për shkak të karakteristikave personale - që nuk kanë të bëjnë me llojin, familjen apo gjininë - nuk mundet të rritet më vonë<sup>15</sup>. Në bazë të dispozitës të nenit 263 paragrafi 4 të „TMPBE” personat juridikë apo fizikë kanë legjitimitetin të ngrenë padi lidhur me anulimin e atyre akteve juridike të cilat formalisht janë nxjerrë si rregullore dhe që kështu nuk “kanë adresat” të vetin, mirëpo i prekin këta (pra paditësit) drejtpërsëdrejti dhe individualisht. Pra këtu kemi të bëjmë me ato dispozita të një rregulloreje të cilat në bazë të natyrës së vet juridike janë vendime. Qëllimi i kësaj norme është që t’i pengojë organet e Bashkimit Evropian, që duke zgjedhur formën e një rregulloreje për nxjerrjen e një akti juridik, të pamundësojë ngritjen e padive kundër këtyre akteve juridike nga ana e personave juridikë dhe fizikë. Pasi që për klasifikimin

<sup>11</sup> Gjykata e Lartë (Evropiane), Slg. 1971, 897, 908, 1185, 207.

<sup>12</sup> Gjykata e Lartë (Evropiane), Slg. 1963, 213, 238; 1977, 709, 726; 1984, 423, 428.

<sup>13</sup> Gjykata e Lartë (Evropiane), Slg. 1988, 219; BBPS 296.

<sup>14</sup> Gjykata e Lartë (Evropiane), Slg. 1978, 845, 852.

<sup>15</sup> Hemmer/Wüß/Hutcka, Europarecht, f. 206.

e një akti juridik nuk është me rëndësi emërtimi por efekti i tij juridik, atëherë së pari në secilin prej këtyre rasteve duhet shikuar dispozita përkatëse, se a ka efekt të përgjithshëm (atëherë kemi të bëjmë vetëm me një rregullore kundër të cilës personat juridik dhe fizik nuk kanë legjitimitet të ngrehin padi mbi anulimin e saj sipas nenit 263 të “TMPBE”), apo në të vërtetë kemi të bëjmë vetëm me një vendim me efekt konkret që rregullon një çështje të veçantë dhe është nxjerrë në formë rregulloreje.

### **3. Padia mbi mosveprimin e organeve të Bashkimit Evropian**

Në bazë të dispozitës të nenit 265 të “TMPBE” shtetet anëtare, organet e Bashkimit Evropian në kuptimin e nenit 13 të “TBE”, dhe në raste të veçanta edhe personat juridikë apo fizikë munden të ngritin padi para Gjykatës së Lartë (Evropiane) që të vërtetohet se: Parlamenti Evropian, Këshilli Evropian, Këshilli (i Bashkimit Evropian) Komisioni dhe Banka Qendrore Evropiane duke mos ndërmarrë një veprim, pra duke mos nxjerrë një akt të caktuar juridik ka shkelur dispozitat e kontratave themeluese. Nga kjo rrjedh se Gjykatës së Lartë Evropiane - përveçse në rastet e veprimit - i është dhënë kompetenca edhe në rastet e mosveprimit të organeve të Bashkimit Evropian që të gjykojë lidhur me ligjshmërinë e sjelljes së tyre. Për shkak se këtu mungon një akt juridik, pra padia ka për bazë mosveprimin e njërit nga organet e Bashkimit Evropian, këtë padi mund ta quajmë edhe si “*padi në mungesë*“. Pra si objekt i padisë në këto raste është mosmbajtja e një qëndrimi që mund të shkelë kontratat themeluese ose, edhe pse dispozita e nenit 265 të “TMPBE” nuk e thotë shprehimisht këtë, normat juridike të lidhura me zbatimin e tij. Nga kjo që thamë më lartë fillimisht është e paqartë se a duhet konsideruar e paligjshme vetëm mungesa e nxjerrjes së akteve të parashikuar si të detyrueshëm proceduralisht nga kontrata themeluese, apo është një e metë dhe mungesa e nxjerrjes së akteve për të cilat një institucion gjykon vetë se kur duhet t’i nxjerr ato dhe kur jo. Edhe pse mund të flasim për paligjshmëri në kuptimin teknik vetëm në rastin e parë, nuk duket e palogjikshme të pranojmë mundësinë e një kontrolli të Gjykatës së Lartë (Evropiane) edhe në hipotezën e dytë duke parë që ndryshe do të nxirreshin nga çdo lloj kontrolli qëndrime ndaj të cilave nuk ekziston, siç është parë, as një kontroll politik efektiv.

Përveç subjekteve të përmendura më lartë, pra shteteve anëtare dhe organeve të Bashkimit Evropian në kuptimin e nenit 13 të “TBE”, janë të legjitimuar të procedojnë pranë Gjykatës së Lartë (Evropiane) edhe personat fizik dhe juridik, edhe pse me disa kufizime si dhe paralajmërimin që për çështjet që kanë për objekt zbatimin e rregullave të konkurrencës që aplikohen ndaj ndërmarrjeve, kompetente për tu shprehur në instancën e parë është Gjykata (e

Bashkimit Evropian)<sup>16</sup>. Në lidhje me këtë paragrafi 3 i nenit 265 të “TMPBE” përcakton shprehimisht që çdo person fizik apo juridik mund ti drejtohet Gjykatës së Lartë (Evropiane) sipas kushteve të parashikuar në paragrafin 1 dhe 2 të po këtij neni, për të kundërshtuar mosveprimin e njërit prej organeve të Bashkimit Evropian, mosveprim ky që ka të bëjë me një akt juridik që nuk është *rekomandim* apo *mendim*. Kundërshtimi që një subjekt i së drejtës së brendshme të shteteve anëtare mund të bëjë duhet të ketë lidhshmëri me mungesën e nxjerrjes së akteve me karakter të detyrueshëm, të cilat do të duhej të ishin nxjerrë në favor të tij. Ky formulim duhet të përjashtojë direktivat, të cilat mund t’i drejtohen vetëm shteteve anëtare, por le të hapur çështjen nëse nga një subjekt privat mund të kundërshtohet përveç shmangia nga nxjerrja e një vendimi dhe shmangia nga nxjerrja e një rregullore. Megjithatë duke pasur parasysh qëllimin që e synon shprehja e paragrafit të 3 të nenit 265 të “TMPBE” është për t’u konkluduar se legjitimiteti i cili i është njohur personave fizikë dhe juridikë për të ngritur padinë para Gjykatës së Lartë (Evropiane) ka të bëjë vetëm me mos nxjerrjen e atyre akteve të cilat janë për t’ju drejtuar individëve<sup>17</sup>. Nga kjo rrjedh se këtu nënkuptohet mosnxjerrja e vendimeve në kuptimin e nenit 288 të “TMPBE” por edhe jo e rregulloreve apo dekreteve pasi që këto nuk janë të dedikuara që t’u drejtohen personave privat. Sipas judikaturës të Gjykatës së Lartë (Evropiane) përkundër shprehjes të paragrafit 3 të nenit 265 të “TMPBE” në procedurën e mosveprimit të organeve të Bashkimit Evropian mund të vërtetohet edhe ligjshmëria e mos nxjerrjes të atyre vendimeve, të cilat janë për t’u drejtuar në një person të tretë, mirëpo paditësin e prekin drejtpërsëdrejti dhe individualisht<sup>18</sup>. Një interpretim i tillë i paragrafit të tretë të nenit 265 të “TMPBE” është i mundshëm në bazë të karakterit unik që kanë normat e neneve 263 dhe 265 të kontratës themeluese. Kjo është paramenduar me qëllim kështu duke pasur parasysh faktin se personave privatë nuk guxon t’u kushtëzohet legjitimiteti për ushtrimin e detyrave të veta me ndërsa sa i përket mos nxjerrjes të akteve normative siç janë rregulloret dhe direktivat, siç kemi cekur edhe më lartë, personave juridik dhe fizik nuk ju njihet legjitimiteti lidhur me ngritje e padis sipas procedurës të nenit 232 të “TMPBE”. Më pastaj paditësi duhet, në bazë të dispozitës të nenit 19 të Statusit të Gjykatës së Lartë të drejtësisë dhe në bazë të nenit 1 të preambulës 38 të Rregullores mbi procedurën e Gjykatës së Lartë të Drejtësisë të parashtrijë arsyet konkrete sa i përket ngritjes të padisë. Këtu nuk mjafton nëse ai thirret vetëm në paraprocedurën! Në bazë të dispozitës të nenit 232, paragrafi i dytë, të Kontratës mbi themelimin e Bashkimit Evropian, një padi sa i përket mosveprimit të

---

<sup>16</sup> Gjykata e Lartë (Evropiane), Slg. 1988, 591.

<sup>17</sup> Erichsen/Weiß, Jura 1990, 528, 535.

<sup>18</sup> Gjykata e Lartë (Evropiane), Rs. C-68/95; EuZW 1997, 61, 64.

një organi të Bashkimit Evropian është e lejueshme vetëm atëherë kur organit përkatës para ngritjes të procedurës i është bërë thirrje që të ndërmarr një veprim të caktuar.

Pra kemi të bëjmë këtu me një paraprocedurë e cila është një parakusht procesual në bazë të cilit edhe përcaktohet objekti i padisë. Paraprocedura fillon me shprehjen e kërkesës me shkrim nga ana e paditësit, nëpërmjet të cilës ai kërkon nga organi përkatës që të merr një veprim të caktuar, gjegjësisht që të nxjerr një akt juridik përkatës. Me këtë rast paditësi duhet për përcaktojë saktësisht aktin juridik, nxjerrjen e të cilit ai synon. Më pastaj shkresa duhet të përmbajë edhe arsyet në bazë të cilave organi përkatës është i obliguar të nxjerr aktin juridik të cilin e lakmon paditësi. Këtu duhet cekur se cilat dispozita të Kontratës mbi themelimin e Bashkësisë Evropiane vijnë në konsiderim. Paditësi duhet t'ia tërheqë vëmendjen organit përkatës, se nëse ky nuk ndërmerr veprimin e caktuar atëherë paditësi do të ngrit padi para Gjykatës së Lartë të Drejtësisë. Kjo shërben, sipas judikaturës të Gjykatës së Lartë të Drejtësisë, për t'ia bërë të çartë organit përkatës të Bashkësisë Evropiane qëllimet dhe seriozitetin e paditësit lidhur me këtë. Padia mbi mosveprimin e organit të Bashkësisë Evropiane mundet të ngritet vetëm atëherë para Gjykatës së Lartë të drejtësisë kur të ketë përfunduar paraprocedura, dhe në qoftë se organi nuk ka përmbushur kërkesën e parashtruar. Sipas dispozitës të nenit 232, paragrafi i dytë, fjalia e dytë, të Kontratës mbi themelimin e Bashkësisë Evropiane, paraprocedura përfundon dy muaj pasi ti jetë bërë e ditur shkresa organit përkatës të Bashkësisë Evropiane. Lidhur me përfundimin e paraprocedurës ekzistojnë kryesisht tri mundësi: Së pari kemi të bëjmë me përfundimin e paraprocedurës në ato raste kur organi i Bashkësisë Evropiane e nxjerr aktin e lakmuar juridik nga personi juridik apo fizik. Në këto raste më nuk ka bazë për ngritjen e padisë mbi mos veprimin sipas nenit 232 të kontratës themeluese. Së dyti kemi të bëjmë me përfundimin e paraprocedurës në ato raste kur organi i Bashkimit Evropian refuzon nxjerrjen e aktit juridik. Në këto raste kemi të bëjmë me një deklaram (mendim) në kuptimin e nenit 232, paragrafi i dytë, të "TMPBE". Një deklaram në kuptimin e nenit 232, paragrafi i dytë, të kontratës themeluese nuk duhet ngatërruar me një deklaram në kuptimin e nenit 249, paragrafi i pestë, po ashtu të kontratës themeluese. Një mendim në kuptimin e nenit 232, paragrafi i dytë, të kontratës themeluese, ndryshe nga një mendim në kuptimin e nenit 249, paragrafi i pestë, ka efekt juridik! Prandaj në këto raste nuk vjen në shprehje padia mbi mosveprimin e organeve të Bashkimit Evropian sipas nenit 232 të kontratës themeluese, por padia mbi ligjshmërinë e akteve të organeve të Bashkimit Evropian sipas nenit 230 të "TMPBE". Dhe më në fund në rastin e tretë kemi të bëjmë me përfundimin e paraprocedurës në ato raste kur organi përkatës i Bashkësisë Evropiane, brenda dy muajve pasi atij ti jetë bërë e njohur shkresa, nuk jep kurrfarë deklarimi lidhur me të, neni 232,



paragrafi i dytë, fjalia e dytë, i “TMPBE”. Në këtë rast paditësit i është hapur rruga për të ngritur padinë pran Gjykatës së Lartë të Drejtësisë lidhur me mosveprimin e organit të Bashkimit Evropian. Afati për ngritjen e padisë përbëhet prej një kohëzgjatje prej dy muaj, pas përfundimit të paraprocedurës, brenda të cilës personat juridikë apo fizikë mundën të ngritin padinë lidhur me mosveprimin e organit përkatës të Bashkimit Evropian, neni 232, paragrafi i dytë, fjalia e dytë, i “TMPBE”. Më në fund Gjykata e Lartë e Drejtësisë duhet të vërtetojë se a është e bazuar padia lidhur me mosveprimin e organit përkatës të Bashkimit Evropian. Sipas dispozitës të nenit 232, paragrafi i parë, të Kontratës/Traktatit mbi themelimin e Bashkimit Evropian, padia mbi mosveprimin e organeve të Bashkimit Evropian është e bazuar, kur organi i paditur në bazë të normave të Kontratës mbi themelimin e Bashkimit Evropian ka qenë i detyruar që të nxjerr aktin juridik të lakmuar. Ndërsa kur kemi të bëjmë me një ushtrim të kompetencës nga ana e organit të Bashkimit Evropian atëherë nuk kemi të bëjmë me një shkelje të kontratës themeluese, me përjashtim kur kemi të bëjmë me një devijim (keq-interpretim-përdorim) të kompetencës. Nëse padia mbi mosveprim ka bazë juridike, atëherë Gjykata e Lartë e Drejtësisë konstaton se organi i paditur duke mos nxjerrë aktin juridik ka shkelur kontratën themeluese. Organi i paditur obligohet që të nxjerrë aktin juridik përkatës, të cilin e përcakton Gjykata në aktgjykim, neni 233, paragrafi i parë, i “TMPBE”.

#### **4. Padia mbi dëmshpërblimin**

Derisa tek procedurat tjera kompetenca lëndore në shkallë të parë e Gjykatës (të Bashkimit Evropian) apo e Gjykatës së Lartë (Evropiane) varet në radhë të parë nga subjektet që e ngritin padinë, tek padia mbi dëmshpërblimin sipas neneve 268 dhe 340 të “TMPBE” në shkallë të parë gjithmonë është kompetente Gjykata (e Bashkimit Evropian), ndërsa Gjykata e Lartë (Evropiane) është kompetente në instancë të fundit. Në bazë të dispozitës të nenit 268 të “TMPBE” në lidhje me nenin 51 të Statutit të Gjykatës së Lartë (Evropiane) juridiksioni i Gjykatës (të Bashkimit Evropian) shtrihet edhe në fushën e përgjegjësisë kontraktore. Këtu përcaktohet shprehimisht se Gjykata (e Bashkimit Evropian) është kompetente të shqyrtojë mosmarrëveshjet lidhur me shpërblimin e dëmit. Po ashtu sipas dispozitës të nenit 340 të “TMPBE” është në kompetencën e Gjykatës (të Bashkimit Evropian) të gjykoj në fushën e përgjegjësisë jashtëkontraktore lidhur me dëmet e shkaktuara nga institucionet e Bashkimit Evropian në ushtrimin e funksioneve të tyre, të cilat Bashkimi Evropian është e detyruar ti dëmshpërblejë në përputhje me parimet e përgjithshme të përbashkëta të së drejtës së shteteve anëtare. Kjo në fakt është një e drejtë që rrjedh nga një burim jashtë kontratave themeluese, që janë pikërisht legjislacionet e shteteve anëtare. Megjithatë nuk kemi të bëjmë me një referim

ndaj këtyre legjislacioneve në tërësinë e tyre, por vetëm në lidhje me parimet e përbashkëta të shteteve të ndryshme në fushën e përgjegjësisë jashtëkontraktore. Në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që i parashtrohen, Gjykata (e Bashkimit Evropian) duhet të bëjë paraprakisht një analizë krahasuese të sistemeve të shteteve anëtare për të nxjerrë drejtimit e përgjithshme të përbashkëta në këtë fushë. Norma juridike të cilën Gjykata (e Bashkimit Evropian) e aplikojnë secilin rast konkret nuk është pra një normë specifike e së drejtës së brendshme, por një normë e formuluar nga gjykata mbi bazën e dispozitave të së drejtës së brendshme të shteteve anëtare. Ndërsa nga parimet e përbashkëta të shteteve anëtare nxirret përcaktimi i çdo aspekti tjetër të padisë së përgjegjësisë, për sa i takon qoftë kufijve të vetpërgjegjësisë, qoftë edhe vlerës së dëmit, qoftë parimit të kërkesave shtesë lidhur për shembull me derdhjen e interesave bankare<sup>19</sup>. Padia që synon të vërtetojë përgjegjësinë jashtëkontraktore të Bashkimit Evropian përbën një rrugëzgjidhje juridike plotësisht autonom me dhe nuk qëndron në lidhje të ngushtë me paditë që kemi shqyrtuar më lartë. Legjitimiteti sa i përket ngritjes së padisë mbi shpërblimin e dëmit i është njohur në përgjithësi të gjithë personave privat juridikë apo fizikë<sup>20</sup>. Një gjë e tillë vlen edhe sa i përket shteteve anëtare, kur kemi të bëjmë me fushën fiskale ekonomiko-private. Ndërsa sa i përket përgjegjësisë lidhur me dëmin e shkaktuar sipas judikaturës të Gjykatës së Lartë (Evropiane) vjen në konsideratë ai organ i Bashkimit Evropian i cili është përgjegjëse për veprimin e paligjshëm të institucionit përkatës<sup>21</sup>. Si objekt i padisë vijnë në shprehje të gjitha ato dëme të shkaktuara nga institucionet e Bashkimit Evropian gjatë ushtrimit të detyrës së tyre. Pra kemi të bëjmë këtu me pretendime në fushën e përgjegjësisë jashtëkontraktore. Këtu para së gjithash kemi të bëjmë me dëmet të cilat i kanë shkaktuar nëpunësit e organeve të Bashkimit Evropian gjatë ushtrimit të detyrave të veta, ku më së shpeshti këto dëme janë shkaktuar nga marrja e vendimeve të paligjshme në kuptimin e nenit 288 të “TMPBE” ndaj personave juridikë apo fizikë, apo nga zbatimi i një mase të caktuar si dhe nëpërmjet të nxjerrjes të një norme antiligjore që mundet të jetë rregullore apo direktivë. Mirëpo vetëm ekzistenca e një qëndrimi/veprimi jo të ligjshëm të Bashkimit Evropian nuk mjafton që të justifikojë pranimin e një padie që synon të vërtetojë përgjegjësinë jashtë kontraktore të vetë Bashkimit Evropian. Për këtë qëllim është e nevojshme të plotësohen dy kushte tjera: së pari duhet të ekzistojë një dëm që varet nga vet qëndrimi/veprimi i Bashkimit Evropian, dhe së dyti dëmi duhet të jetë pasojë e drejtpërdrejtë (kauzal) e vetë këtij qëndrimi.

---

<sup>19</sup> Gjykata e Lartë (Evropiane), Slg. 1983, 1707 e vijim.

<sup>20</sup> Erichsen/Weiß, Jura 1990, 586, 588.

<sup>21</sup> Gjykata e Lartë (Evropiane), Slg. 1973, 1229, 1247.

Në shkresën e vet paditësi duhet të pohojë se pari se vjen në shprehje një përgjegjësi e Bashkimit Evropian. Më pastaj duhet edhe lartësia e dëmit të shifrohet. Deri sa kjo nuk është e mundur të bëhet duhet të parashtrahet kërkesa për përcaktimin e tij<sup>22</sup>.

Sa i përket padisë në kuptimin e nenit 268 të “TMPBE” nuk është paraparë ndonjë afat për parashtrimin e saj, megjithatë përcakton shprehimisht Statuti të Gjykatës së Lartë (Evropiane), se e drejta për dëmshpërblim parashkruhet 5 vite pas shkakimit të dëmit. Pra padia duhet të ngrihet së paku para kalimit të 5 viteve prej momentit të shkakimit të dëmit. Ndërsa në rastet kur paditësi ka shprehur pretendimet e veta përballë organit, të cilit i ngarkohet dëmi i shkakuar, atëherë afati për ngritjen e padisë përmban dy muaj në bazë të dispozitës të nenit 263 paragrafi 5 të “TMPBE”. Paditësit i takon e drejta e shpërblimit të dëmit vetëm atëherë kur me të vërtetë tërësia e rrethanave që kanë shkakuar dëmin e justifikojnë një gjë të tillë.

Sa i përket përgjegjësisë së Bashkimit Evropian kjo përcaktohet në bazë të parimeve të përgjithshme të përbashkëta të së drejtës së shteteve anëtare. Sipas juridikaturës së Gjykatës së Lartë (Evropiane) drejta për shpërblimin e dëmit në përgjithësi ekziston vetëm atëherë kur veprimi zyrtar i nëpunësve të organeve të Bashkimit Evropian është i paligjshëm, kur dëmi ekziston me të vërtetë dhe kur ky veprim është shkaktar/kausal për shkakimin e dëmit<sup>23</sup>.

Në bazë të dispozitës të nenit 340 paragrafi 2 të “TMPBE” një përgjegjësi e Bashkimit Evropian vjen në shprehje kur veprimi, për të cilin ngarkohet Bashkimi Evropian, është ndërmarrë nga organet e tij gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre. Pra kur nëpërmjet të këtij veprimi është synuar ushtrimi i funksionit zyrtar. Më pastaj veprimi i nëpunësve apo organeve të Bashkimit Evropian duhet të jetë antiligjor. Sa i përket joligjshmërisë këtu dallojmë: përgjegjësinë për aktet administrative joligjore (*padrejtësia administrative*) dhe përgjegjësinë për nxjerrjen e normave antiligjore (*padrejtësia legislative*).

Në sferën e padrejtësisë administrative kemi të bëjmë me një shkelje të një norme të drejtës evropiane që shërben edhe për mbrojtjen e interesave individuale<sup>24</sup>. Këtu mjafton kur kemi të bëjmë me një shkelje të një norme që ka në përgjithësi karakter të përgjithshëm mirëpo edhe pjesërisht i përkrah interesat privat<sup>25</sup>. Ndërsa kur kemi të bëjmë me sferën e padrejtësisë legislative, kur organeve të Bashkimit Evropian ju është lënë një hapësirë manovrimi si për shembull sa i përket vendimeve ekonomiko-politike, nuk mjafton shkelja e një norme që shërben për mbrojtjen e interesave individuale<sup>26</sup>. Lidhur me këtë këtu është e nevojshme që kemi një rast të kualifikuar të joligjshmërisë. Kjo është paramenduar para së gjithash kështu

<sup>22</sup> Gjykata e Lartë (Evropiane), Slg. 1967, 711, 743.

<sup>23</sup> Gjykata e Lartë (Evropiane), Slg. 1990, I-1981.

<sup>24</sup> Grabitz, Art. 215, Rnd. 75.

<sup>25</sup> Gjykata e Lartë (Evropiane), Slg. 1976, 332, 355.

<sup>26</sup> Hemmer/Wüst/Hutka, Europarecht, f. 221.

me qëllim që të mbrohet e drejta e organeve të Bashkimit Evropian sa i përket mundësisë për manovrim. Sipas juridaturës të Gjykatës së Lartë (Evropiane) përgjegjësia e Bashkimit Evropian vjen në shprehje sa i përket padrejtësisë legislative, vetëm atëherë kur kemi të bëjmë me një rast të kualifikuar të joligjshmërisë, pra kur kemi të bëjmë me një shkelje të theksueshme dhe të rënd të një norme e cila shërben edhe për mbrojtjen e interesave individuale<sup>27</sup>. Pra këtu vijnë në shprehje para së gjithash rastet kur kemi të bëjmë me një devijim të kompetencës i cili është i çartë dhe kufizohet me një vendim arbitrar.

Në praktikë është shumë e vështirë që të justifikohet e drejta për shpërblimin e dëmit kur kemi të bëjmë me padrejtësinë legislative, për shkak të premisave përkatëse që janë shumë specifike! Më pastaj është e nevojshme që të ekzistojë një dëm konkret. Ky përcaktohet sipas hipotezës së diferencës. Mirëpo është e pamundur edhe shpërblimi i fitimit të humbur!

Dhe në fund është e nevojshme që veprimi i nëpunësve apo i organit të Bashkimit Evropian të jetë kauzal për dëmin e shkaktuar. Pra ky duhet të ketë shkaktuar drejtpërsëdrejti dëmin.

Një akt joligjor i organeve të Bashkimit Evropian është kauzal për dëmin edhe atëherë kur ky shkaktohet nga një akt nacional i shteteve anëtare, i cili është nxjerrë për të zbatuar detyrimin e dalë nga akti i Bashkimit Evropian. Nëse të gjitha këto premisa janë të plotësuara atëherë Bashkimi Evropian është i detyruar të kompensoj dëmin përkatës.

## **5. Mjetet tjera juridike**

Juridiksioni gjykatave të Bashkimit Evropian nuk është i kufizuar vetëm në mjetet e lartpërmendura juridike. Lidhur me këtë është për tu përmendur dispozita e nenit 267 të “TMPBE” e cila Gjykatës së Lartë (Evropiane) i njeh edhe një juridiksion jo-gjyqësor në cilësi paragjykimore mbi interpretimin e kontratave dhe mbi vlerëshmërinë dhe interpretimin e akteve të institucioneve të Bashkimit Evropian. Këtu kemi të bëjmë me një *kompetencë ekskluzive* të një rëndësie të veçantë, të predestinuar që të evitojë që gjyqtarët e gjykatave nacionale të shteteve anëtare t'i japin kuptime të ndryshme dispozitave të kontratave themeluese dhe akteve të institucioneve të Bashkimit Evropian të cilat duhet të gjejnë aplikim në sistemet e brendshme juridike të shteteve anëtare.

## **IV. Rezyme**

Sistemi gjyqësor i Bashkimit Evropian garanton ushtrimin e kontrollit të ndërsjellët të veprimeve të Organeve të Bashkimit Evropian dhe të shteteve anëtare nëpërmjet të ushtrimit të mjeteve të ndryshme juridike pranë gjykatave përkatëse të Bashkimit Evropian. Procedurat përkatëse dhe të drejtat e subjekteve të procedurës janë të rregulluara në Traktatin e Bashkimit Evropian, Traktatin e Mënyrës së Punës të Bashkimit Evropian si dhe në Statutet dhe

---

<sup>27</sup> Gjykata e Lartë (Evropiane), Slg. 1971, 985.

Rregulloret e Punës të gjykatave përkatëse. Sistemi gjyqësor i Bashkimit Evropian funksionon sipas modelit „*Supreme-Court*” që do të thotë se të gjitha fushëlëmit juridike bashkohen në një gjykatë në instancën e fundit, pra në Gjykatën e Lartë (Evropiane).

### **Bibliografia:**

*Bashkim Zahiti*: E Drejta Evropiane, Botimi i tretë, Prishtinë 2013.

*Christian Rahde/Stefan Lorenzemeier*: Europarecht, schnell erfasst, 2., vollständig überarbeitet Auflage, Berlin, Heidelberg, New York, Barcelona, Hongkong, London, Mailand, Paris, Singapur, Tokio 1999.

*Christian Callies/Mathias Ruffert*: Kommentar zu EU-Vertrag und EG-Vertrag, Neuwied, Krefeld 1999.

*Erichsen/Weiß*: Juristische Ausbildung (Jura 1990), Berlin 1990.

*Hemmer/Wüst/Hutka*: Europarecht, Juristisches Repititorium, 10., Auflage, Würzburg 2011.

*Oppermann/Classen/Nettesheim*: Europarecht, 5. Auflage, München 2011.

*Rudolf Streinz*: Europarecht, 9. Auflage, Heidelberg, München, Landsberg, Frechen, Hamburg 2012.

*Stephan Hobe*: Europarecht, 6., neu bearbeitete Auflage, München 2011.